



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 14.11.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Munguan : Rasim Demiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MB, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 9.11.2011,**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për rregullimin e tokës,**
4. **Shqyrtimi i planit të veprimit për integritet evropiane, për vitin 2012,**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.11.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 9.11.2011. **Daut Haradinaj** kishte vërejtje në procesverbalin e dt. 3.11.2011, mirëpo stafi njoftoi se ky procesverbal tanimë është i miratuar nga komisioni, njëkohësisht deputetët u njoftuan se Këshilli për trashëgimin kulturore duhet të dërgoj komisionit raportin me shkrim për Hoçën dhe Prizrenin për shkak të temës së ndryshme.

3. Shqyrtimi i projektligjit për rregullimin e tokës

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi se mbledhja e sotme është çrregulluar pak sa për shkak të mbledhjes plenare të sotme, ndaj në vazhdim u shqyrtuan vetëm dy amendamente të propozuara nga ekspertët, për të vazhduar mbledhjen të mërkurën me pikat e sotme dhe disa tjera.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani